



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira - Departament Slobodnih Profesija -
Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.18/2023

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore, lidhur me veprimet përmbarimore në lëndët përmbarimore, P.nr.814/22, P.nr.815/122, P.nr.816/122 dhe P.nr.817/122, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Fadilete Hoxha-Blakqori, pala ankuese, të cilën e përfaqëson me autorizim avokat nga dhe personalisht Përmbaruesi Privat, me datë 13.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-18/2023 i datës 07.08.2023, si dhe ankesa e palës ankuese e datës 26.07.2023, si të pabazuara.

II. Përmbaruesi Privat, si organ përmbarues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore, P.nr.814/22, P.nr.815/122, P.nr.816/122 dhe P.nr.817/122.

A r s y e t i m

Pala ankuese, ka parashtruar ankesë ndaj përmbaruesit privat, me të cilën se pretendon se përmbaruesi privat lëndor, nuk e ka respektuar komunikimin e procedurës më debitorin pasi që

debitori nuk ka qenë i njoftuar lidhur me lejimin e urdhrin përmbarrimor, dhe njëkohësisht nuk iu ka dhënë mundësia për të ushtruar prapësim. Mëtej pala, ankuese deklaroi se debitori me vite të tëra e ka selinë në vendin e njëjtë ku e është edhe tani, poashtu përmbarruesi privat ka mundur të kontaktoi me debitorin edhe përmes emali-it të debitorit, pasi që kemi të bëjmë me person juridik. Poashtu pala ankuese ka deklaruar se përmbarruesi privat në këtë rast i ka lejuar katër lëndë ndaras vetëm për çështjen e njëjtë duke i shkaktuar shpenzime të panevojshme debitorit. Andaj për këtë çështje debitori ju ka drejtuar gjykatës kompetente lidhur me ruajtjen e afatit të prapësimi pasi që i njëjti është rënë në dijeni për lejimin e urdhre përmbarrimor.

Me datën 07.08.2023, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin për Përfundimtar, ndaj përmbarruesit privat, lidhur me veprimet përmbarrimore për këtë rast, të cilin raport e kanë prezantuar edhe në seancën dëgjimore, duke mbetur në tërësi pranë ankesës se ushtruar nga pala ankuese.

Përmbarruesi Privat, në seancën dëgjimore ka theksuar se pretendimet e palës ankuese janë të pa qëndrueshme sepse i tërë komunikimi është bërë konform dispozitave të LPK-së, siç janë paraqitur provat shkresore të komunikimit në shkresat e lëndës. I ka propozuar komisionit që të refuzohet ankesa si e pabazuar.

Përfaqësuesja e autorizuar e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, ka bërë shtjellimin e Raportit përfundimtar. Po ashtu edhe pala ankuese si dhe përmbarruesi privat, kanë ngelur pranë pretendimeve ankimore, deklarimeve në seancë dëgjimore.

Pas seancës dëgjimore dhe dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar në mënyrë shteruese gjitha pretendimet e palëve dhe ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim që Përmbarruesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor, vlerësoi pretendimin e palës ankuese se nuk është respektuar komunikimi në procedurës me debitorin sipas ligjit në fuqi, pasi që debitori nuk ka qenë i njoftuar lidhur me lejimin e urdhre përmbarrimor, dhe njëkohësisht nuk iu ka dhënë mundësia për të ushtruar prapësim, këto janë pretendime të pa qëndrueshme ngase përmbarruesi privat fillimisht ka tentuar që të vë kontakt me palën ankuese edhe dështimit të kontaktit procedural, përmbarruesi privat i ka afishuar shkresat për komunikim me palën ankuese në tabelën e shpalljeve, konform dispozitave

të LPK-së. Për këto arsye komisioni vlerëson se përmbaruesi privat nuk është përgjegjës për asnjë nga shkeljet e masave disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së, sepse të gjitha veprimet përmbarimore për rastin të cilën është paraqitur ankesa janë në harmoni me dispozitat e LPP-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr.18/2023 datë 13.11.2023

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor
Manushe Karaçi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.